



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-06

**Vendosi:** Gjykatësi i procedurës paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 26 tetor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Version i redaktuar publik i fletarrestimit për Rexhep Selimin**

---

**Prokurorit të Specializuar**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Rexhep Selimit**

**T'i dorëzohet**

Rexhep Selimit

**UNË, GJYKATËS NIKOLA GIJU**, gjykatës i procedurës paraprake i Dhomave të Specializuara të Kosovës, i caktuar prej Kryetares së Dhomave të Specializuara në përputhje me nenin 33(1)(a) të Ligjit nr. 05/L-53 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”);

**PASI KAM MARRË** parashtrimet konfidenciale dhe *ex parte* të Zyrës së Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) me tituj “Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim” të datës 24 prill 2020 dhe, “Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për konfirmim” të datës 24 korrik 2020;

**PASI KAM KONFIRMUAR** Aktakuzën e Rishikuar (“Aktakuza e Konfirmuar”) në “Vendim për konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit” të datës 26 tetor 2020, dhe pasi kam konstatuar aty se ekziston dyshim i bazuar mirë që z. Rexhep Selimi (“z. Selimi”) ka kryer ose ka marrë pjesë në kryerjen e veprave penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara;

**BAZUAR NË** nenet 35(3), 39(3), 41, 53, 54 dhe 55 të Ligjit dhe rregullat 50, 53, 55, 86(6)(b) dhe 208(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”);

### LËSHOJ FLETARRESTIM PËR

**REXHEP SELIMIN**, gjithashtu i njohur si “Dhjetëshi”, “Agroni”, “Tafili”, ose “Lulzimi”, i lindur më **15 MARS 1971** në **AQAREVË, KOMUNA E SKËNDERAJT**, Kosovë, aktualisht me shtetësi kosovare, **NUMRI PERSONAL [REDAKTUAR]**, me adresë të fundit të njohur [REDAKTUAR] **PRISHTINË**, Kosovë.

## A. VEPRAT PENALE DHE PARAQITJE E SHKURTËR E FAKTEVE

1. Sikurse parashtrohet në Aktakuzën e Konfirmuar, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Selimi mban përgjegjësi penale për krimet kundër njerëzimit të përndjekjes (Pika 1), burgimit (Pika 2), veprimeve të tjera çnjerëzore (Pika 4), torturës (Pika 6), vrasjes së paligjshme (Pika 8), dhe zhdukjes me forcë të personave (Pika 10), dhe për krimet e luftës të ndalimit arbitrar (Pika 3), trajtimit mizor (Pika 5), torturës (Pika 7), dhe vrasjes së paligjshme (Pika 9), përkatësisht në shkelje të nenit 13(1) dhe nenit 14(1)(c) të Ligjit. Në lidhje me këto krime, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Selimi mban përgjegjësi penale, në bazë të nenit 16(1)(a) të ligjit, për:

- (i) kryerje si anëtar i një ndërmarrjeje kriminale të përbashkët ("NKP"), të krimeve të përfshira në Pikat 1-10, dhe si alternativë, kryerje si anëtar i NKP-së së lartpërmendur, të krimeve të përfshira në Pikat 1-10, duke qenë i vetëdijshëm se krime të tilla mund të kryheshin gjatë realizimit të qëllimit të përbashkët të NKP-së dhe duke e marrë përsipër këtë rrezik me vullnet të lirë; dhe
- (ii) gjithashtu dhe si alternativë, për ndihmë dhe inkurajim të krimeve të përfshira në Pikat 1-10.

2. Më tej dhe si alternativë të përgjegjësisë së pretenduar në bazë të nenit 16(1)(a) të Ligjit, ekziston dyshim i bazuar mirë se z. Selimi mban përgjegjësi penale për krimet e përfshira në Pikat 1-10 si epror, në bazë të nenit 16(1)(c) të Ligjit.

3. Sikurse përshkruhet në Aktakuzën e Konfirmuar, këto krime u kryen për afërsisht gjatë periudhës prill 1998 - gusht 1999 në një numër vendndodhjesh në Kosovë dhe Shqipërinë veriore, ndër të cilat, në Bare dhe Bajgorë; [REDAKTUAR]; Malet e Berishës; [REDAKTUAR]; Cahan në Shqipëri; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; Drenoc; Ferizaj; Gjilan; [REDAKTUAR]; Jabllanicë; [REDAKTUAR]; Kleçkë; Kukës në Shqipëri; Likoc; Llapashticë; Llapushnik; Majac; Malishevë dhe Shpellën e Volljakës; [REDAKTUAR]; Novobërdë; Potok; Prishtinë; Prizren; [REDAKTUAR]; Rahovec;

[REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; Suharekë; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; [REDAKTUAR]; dhe Zllash.

4. Krimet e përfshira në Pikat 1, 2, 4, 6, 8, dhe 10 u kryen në kuadër të një sulmi gjerësisht të përhapur ose sistematik kundër popullatës civile të "kundërshtarëve" në Kosovë dhe në Shqipërinë veriore, më së paku që prej marsit 1998 deri në shtator 1999, d.m.th., kundër atyre të cilët konsideroheshin se: (i) kishin bashkëpunuar ose ishin të lidhur me forcat, zyrtarët ose institucionet shtetërore të Republikës Federale të Jugosllavisë ("RFJ"; ose (ii) ndryshe nuk përkrahnin synimet ose metodat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK") dhe më vonë të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, ndër të cilët persona të lidhur me Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe serbë, romë e persona të kombësive të tjera.

5. Krimet e përfshira në Pikat 3, 5, 7, dhe 9 u kryen kundër personave që nuk merrnin pjesë aktive në luftime dhe në kontekstin e, dhe në lidhje me konfliktin e armatosur jondërkombëtar në Kosovë ndërmjet UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe Republikës së Serbisë, ndër të cilat njësite të Ushtrisë Jugosllave, njësite policore dhe njësite të tjera të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe grupe të tjera që luftonin në emër të RFJ-së dhe të Serbisë, së paku që prej marsit 1998 deri afërsisht më 16 shtator 1999.

#### B. DOMOSDOSHMERIA E ARRESTIMIT

6. Arrestimi i z. Selimi është i domosdoshëm në përputhje me nenin 41(6)(b) të Ligjit. Ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se: (i) ekziston rreziku i arratisjes së tij, duke qenë se ai është në dijeni të akuzave kundër tij që përfshihen në Aktakuzën e Konfirmuar, si dhe të dënimeve të mundshme që mund të përfshijnë dënim deri në burgim të përjetshëm; (ii) është në dijeni të vendimeve për fajësi penale të ish-anëtarëve të lartë të UÇK-së dhe të anëtarëve të identifikuar të NKP-së, të cilat janë raportuar publikisht; (iii) aktualisht është deputet i Kuvendi të Kosovës dhe në të shkuarën ka mbajtur poste të ndryshme qeveritare dhe ka mundësinë që të mobilizojë

lehtësisht një rrjet të gjerë përkrahësish dhe zyrtarësh të qeverisë ndër të cilët edhe persona me ekspertizë në lëmin e sigurisë, policisë dhe inteligjencës; (iv) ka qasje në fonde të konsiderueshme; dhe (v) ka mundësinë që të udhëtojë lirisht; (b) mund të pengojë procedimin me anë të ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve, viktimave, ose bashkëkryesve, duke marrë parasysh se ai (i) ka post me pushtet dhe ndikim në Kosovë çka i mundëson të mobilizojë një rrjet të gjerë përkrahësish për të penguar hetimet e ZPS-së; (ii) është përfshirë prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në një listë të personave të cilëve u është bllokuar pasuria për arsye se ka kërcënuar përpjekjet ndërkombëtare për stabilizimin e Ballkanit Perëndimor, ndër të tjera përmes përfshirjes së mundshme të tij në pengimin e zbatimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që themeloi UNMIK-un; dhe (iii) pretendohet se ka tentuar të ndërhyjë në një procedim tjetër në lidhje me orvatjen për vrasje të një anëtari të Lidhjes Demokratike të Kosovës; dhe (c) duke marrë parasysh pjesëmarrjen e tij të pretenduar në NKP kundër kundërshtarëve realë ose të imagjinuar të UÇK-së, orvatjet e tij të pretenduara për pengimin e procedimit dhe atmosferën e përgjithshme të frikësimit të dëshmitarëve të cilët kanë dëshmuar kundër anëtarëve të UÇK-së në të shkuarën, ai mund të kryejë krime të tjera kundër personave të cilët konsiderohen si kundërshtarë të UÇK-së, përfshirë viktima dhe dëshmitarë.

### C. ZBATIMI I FLETARRESTIMIT

7. Duke qenë se sipas informacionit aktualisht të disponueshëm, z. Selimi jeton në Kosovë, gjykatësi i procedurës paraprake urdhëron ZPS-në që të zbatojë dhe dorëzojë këtë fletarrestim. Në bazë të nenit 35(3) të Ligjit, policia në kuadër të ZPS-së ka autoritetin dhe përgjegjësinë për të ushtruar kompetencat që ka Policia e Kosovës në bazë të legjislacionit të Kosovës dhe rrjedhimisht mund të konsiderohet “autoritet kompetent” në bazë të rregullës 49(1) të Rregullores për zbatimin dhe dorëzimin e këtij fletarrestimi. Gjykatësi i procedurës paraprake rikujton se, në bazë të neneve

53(3) dhe 54(1) të Ligjit, Dhomat e Specializuara kanë përparësi kundrejt të gjitha gjykatave të tjera në Kosovë dhe se ky fletarrestim ka fuqi dhe efekt të njëjtë me fletarrestimet e lëshuara nga cilado gjykatë tjetër e Kosovës. Në përputhje me nenin 53(1) të Ligjit, të gjithë subjektet dhe personat në Kosovë, ndër të cilët zyrtarë qeveritarë, bashkëpunojnë me ZPS-në dhe Dhomat e Specializuara dhe përmbushin pa vonesë çdo urdhër ose vendim të tyre.

8. Në qoftë se ekziston informacion se z. Selimi ndodhet në territorin e një shteti të tretë, Administratorja ua përcjell fletarrestimin autoriteteve kompetente të atij shteti, me kërkesë që fletarrestimi të zbatohet dhe dorëzohet në praninë e përfaqësuesve të ZPS-së, në përputhje me nenin 55 të Ligjit. Prej shtetit të tretë gjithashtu kërkohet që të informojë pa vonesë Administratoren për datën, orën, vendin dhe çdo hollësi tjetër të rëndësishme lidhur me arrestimin dhe transferimin e z. Selimi në Dhomat e Specializuara, në përputhje me nenin 55 të Ligjit. Në rast se hasin në vështirësi apo pengesa teknike ose logjistike gjatë zbatimit të këtij fletarrestimi, autoritetet kompetente të shtetit të tretë ftohen që të informojnë përfaqësuesit e ZPS-së dhe/ose të Zyrës Administrative, sipas rastit, për këto vështirësi ose pengesa.

#### D. TRANSFERIMI DHE OBJEKTI I PARABURGIMIT

9. Në përputhje me nenin 3(8)(a) dhe (d), dhe nenin 41(5) dhe (7) të Ligjit, si dhe rregullën 55(4) të Rregullores, pas arrestimit z. Selimi do të transferohet në objektin e paraburgimit në Holandë ("shteti pritës"), i mbikëqyrur nga Dhomat e Specializuara dhe i administruar nga Zyra Administrative. Administratorja zbaton urdhrin për transferim dhe bën përgatitjet e nevojshme për transferimin pa vonesë të z. Selimi.

## E. TË DREJTAT E Z. SELIMI

10. Pas arrestimit, z. Selimi gëzon të drejtat e parapara në nenet 21 dhe 41(4) të Ligjit, të cilat duhet t'i lexohen në kohën e arrestimit nga ZPS-ja, ose pas transferimit në paraburgim të Dhomave të Specializuara, sipas rastit.

11. Z. Selimi do të sillet para gjykatësit të procedurës paraprake pa vonesë, në përputhje me nenin 41(5) të Ligjit.

12. Në bazë të nenit 41(2) dhe (5) të Ligjit, z. Selimi ka të drejtë t'i paraqesë gjykatësit të procedurës paraprake ankesë lidhur me ligjshmërinë e arrestimit të tij, të urdhrin për transferim dhe kushtet e paraburgimit, si dhe të paraqesë apel në Dhomën e Specializuar të Gjykatës së Apelit.

## F. KËRKESA DHE URDHRA TË TJERË

13. Ky fletarrestim, aktualisht i klasifikuar si konfidencial dhe *ex parte*, mund t'u komunikohet, ose ekzistenca e tij mund t'u bëhet e ditur, të akuzuarit z. Selimi dhe autoriteteve kompetente të Kosovës ose të shteteve të treta, ndër të cilat shteti pritës, nëse është e nevojshme për zbatimin e tij.

14. Duke marrë parasysh klasifikimin e këtij fletarrestimi, gjykatësi i procedurës paraprake kërkon prej autoriteteve kompetente të Kosovës ose të cilitdo shteti të tretë, sipas rastit, të mos ia bëjnë të ditur askujt ekzistencën e këtij fletarrestimi dhe përmbajtjen e tij, përveçse atyre personave përfshirja e të cilëve është absolutisht e domosdoshme për zbatimin e fletarrestimit dhe dorëzimin e tij z. Selimi.

15. Në rast se një subjekt, një zyrtar i qeverisë së Kosovës, ose cilido person tjetër në Kosovë, pengon zbatimin e këtij fletarrestimi, kjo mund të përbëjë shkelje në bazë të nenit 15(2) të Ligjit.

\_\_\_\_\_  
/nëshkrim/

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatës i procedurës paraprake**

E hënë, 26 tetor 2020

Në Hagë, Holandë.